



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Ministrinë e
Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Kombëtarë të Burimeve
Natyrore (AKBN)**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK

PËRPUTHSHMËRIE

“Mbi monitorimin e HEC Sasaj, Sarandë”

TIRANË, MAJ 2025

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3-6
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4
3	Konkluzioni i përgjithshëm	6
II	HYRJA.....	6-10
1	Objektivat dhe qëllimi.....	7
2	Identifikimi i çështjes.....	7
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	7
4	Përgjegjësitë e audituesve.....	8
5	Kriteret e vlerësimit.....	8
6	Standardet e auditimit.....	9
7	Metodat e auditimit.....	9
8	Dokumentimi i auditimit.....	10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	10-25
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	10-10
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	10-10
2.1	Mbi marrëveshjen koncesionare për HEC “Sasaj”, shtesat dhe ndryshimet, leje dhe autorizime, sigurime, etj.....	10-12
2.2	Mbi monitorimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të shoqërisë koncesionare për të gjitha fazat e ndërtimit dhe të operimit të HEC “Sasaj”, si dhe propozime dhe aplikime penalitetesh, për mos zbatim të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore.....	12-15
2.3	Mbi masat e marra nga ana e Koncesionarit në lidhje me sigurinë e digës dhe të veprave të tjera të HEC “Sasaj”. Raporti i shfrytëzimit dhe gjendjes së strukturave të HEC-it, si dhe i punimeve të mirëmbajtjes.....	16-23
2.4	Mbi pasojat e shkaktuara nga dëmtimi i digës së ujëmbledhësit të HEC Sasaj dhe masat e marra për rikuperimin e tyre.....	23-25
V	GJETJE DHE REKOMANDIME.....	25-31

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

Bazuar në Programin e Auditimit nr. 131/1, datë 20.01.2025, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MEI) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), “Mbi monitorimin e HEC Sasaj”, Sarandë.

1. Përshkrim i shkurtër i institucioneve.

Me VKM Nr. 634, datë 18.09.2003 është miratuar fillimi i procedurës së ndërtimit me Koncesion të formës “BOO”, të Hidrocentralit të Sasajt dhe me VKM Nr. 501, datë 23.07.2004, është miratuar Marreveshja e Koncesionit për Ndërtimin e Hidrocentralit të Sasajt e formës “BOO”, lidhur ndërmjet METE, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), dhe Konsorciumit të shoqërive të projektit të ndërtimit të HEC Sasaj.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është ent publik me seli në Tiranë e krijuar sipas VKM Nr. 547, datë 9.8.2006, i ndryshuar, nga bashkimi i Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve, Institutit të Studimeve dhe Projektive të Metalurgjisë, Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve dhe Institutit të Studimeve dhe Projektive të Mekanikës dhe Drurit dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë. Ky institucion është në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe ka si objekt të punës së tij zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin mineral, hidrokarbur dhe energjetik. Struktura, organika dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përcaktohen në statut-rregulloren e kësaj agjencie, e cila miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës.

- Qëllimi i auditimit.

Ky auditim trajton problematikat e evidentuara në HEC Sasaj, pas dëmtimit të basenit të presionit, pasojë e të cilit është dalja nga puna e vetë HEC-it, por dhe janë shkaktuar dëme palëve të treta nga vërshimi i ujërave.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese, sa është e mundur nga koncesionari dhe subjektet e audituara. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi marrëveshjen koncesionare për HEC “Sasaj”, shtesat dhe ndryshimet, leje dhe autorizime, sigurime, etj.
- Mbi monitorimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të shoqërisë koncesionare për të gjitha fazat e ndërtimit dhe të operimit të HEC “Sasaj”, si dhe propozime dhe aplikime penalitetesh, për mos zbatim të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore.
- Mbi masat e marra nga ana e Koncesionarit në lidhje me sigurinë e veprave të HEC “Sasaj”. Raporti i shfrytëzimit dhe gjendjes së strukturave të HEC-it, si dhe i punimeve të mirëmbajtjes.
- Mbi pasojat e shkaktuara nga dëmtimi i digës së ujëmbledhësit të HEC Sasaj dhe masat e marra për rikuperimin e tyre.

- Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar dokumentacionin që ka të bëjë me marrëveshjen e koncesionit, dokumentacionin e paraqitur nga koncesionari në MIE dhe AKBN, monitorimet e realizuara nga ana e AKBN, verifikim i dëmit të shkaktuar në objekt, dokumentacion mbi dëmet mjedisore të shkaktuara nga mos lënia e ujit ekologjik etj. Metodat

e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e auditimit si shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në terren etj.

2. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultuan mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, si në fazën e ndërtimit, ashtu dhe në fazën e prodhimit të HEC Sasaj. Grupi i auditimit ka konstatuar gjetje dhe ka dhënë 10 rekomandime për masa organizative.

Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- Me datë 21.01.2025, grupi i auditimit realizoi një verifikim në objektet përbërëse të HEC Sasaj. Verifikimi u përqendrua në dëmet që ka pësuar struktura e basenit me presion, me kapacitet të parashikuar 12000 m³. Nga verifikimi rezultoi se, struktura mbajtëse rrethuese e basenit të presionit kishte pësuar dëmtim për pasojë derdhje të ujit të depozituar, duke shkaktuar dëme të bimësisë në rrjedhën e malit si dhe në banesa, biznese dhe infrastrukturë. Gjithashtu u konstatua se, krahas shembjes së murit të basenit, në pllakën beton arme të bazamentit të basenit kishte një çarje, e cila është shkaktuar kohë më parë. Çarje të tilla vijnë si pasojë e dobësimit të bazamentit, nga i cili krijohen ulje jo të njëtrajtshme, duke bërë që betoni të punojë në përkulje me forcë më të madhe nga ajo e projektuar. Kjo trysni jep ndikim edhe në aftësinë mbajtëse të mureve mbajtëse, duke kaluar masën e projektuar dhe rrjedhimisht dëmtim të tyre.

- Nga ana e AKBN-së nuk janë realizuar monitorime të mjaftueshme për HEC Sasaj, por dhe për hec-eve të tjerë. Mungesa e monitorimeve ka lidhje me mos respektimin nga ana e koncesionarëve të marrëveshjeve përkatëse për paraqitje dokumentacioni në mënyrë periodike, si dhe me mangësi në inspektimet që realizohen në këto hec-e nga ana e AKBN-së.

- Bazuar në ngjarjen e ndodhur, ku baseni i presionit të HEC Sasaj është dëmtuar, u konstatua se nga ana e koncesionarit nuk janë marrë masa të vazhdueshme për sigurinë e veprave përbërëse të HEC Sasaj dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla. Si pasojë e shembjes së murit të basenit të presionit një sasi e konsiderueshme uji ka vërshuar në zonën e banuar duke shkaktuar dëme të bimësisë, të pronave të familjarëve dhe bizneseve të zonës.

Nga ana e grupit të auditimit, me datë 21.01.2025, u verifikua dëmtimi i basenit të presionit të HEC Sasaj, si dhe dëmet e shkaktuara nga vërshimi i ujit. Nga verifikimi u konstatua se, si pasojë e vërshimit të ujit të basenit të presionit, janë shkaktuar dëme në lidhje me bimësinë poshtë basenit, në ndërtesat e banorëve dhe bizneseve si pasojë e zhvendosjes nga uji të baltës dhe të masivëve shkëmborë. Po ashtu, vërshimi i ujit ka përmbytur një pjesë të territorit të nënstacionit elektrik të zonës, por që në momentin e verifikimit ishte funksional.

- Bazuar në lejen mjedisore për ndërtimin e HEC Sasaj, dhënë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1161/3 prot., datë 20.02.2012, pika 3.2 cilësohet: “Me qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyralitetit të përroit në segmentin ku do të ndërtohet hidrocentrali, shoqëria të lejojë hedhjen në shtratin ekzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit Qekologjike = 15 % të prurjes natyrale të lumit dhe të burimeve. Në stinë të thatë kjo përqindje do të jetë më e lartë, në bazë të prurjeve të lumit (deri në 100 % të prurjes), duke mos lejuar në asnjë mënyrë që në rrjedhën e lumit të mos ketë ujë. Kjo sasi uji duhet të lihet në rrjedhën ekzistuese të lumit gjatë të gjithë kohës së funksionimit apo shfrytëzimit të HEC-it.

- Bazuar në raportin e monitorimit për 6-mujorin e parë të vitit 2010, të realizuar nga AKBN, kërkesës për paraqitje dokumentacioni, koncesionari i është përgjigjur vetëm me paraqitjen e disa situacione punimesh, pa nënshkrimin e ndonjë mbikëqyrësi të punimeve. Gjithashtu, koncesionari nuk ka paraqitur policat e sigurimit. Në konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti përcaktohet se koncesionari nuk ka përfunduar punimet brenda 40 muajve nga hyrja në

fuqi e marrëveshjes, ose brenda 18.02.2007, por ato janë në fazë fillestare. Në këtë raport cilësohet se koncesionari duhet të penalizohet për vonesa sipas përcaktimeve kontraktore, veprim i cili nuk rezulton i plotësuar. Edhe në raportin e monitorimit për 6 mujorin e dytë të vitit 2010 dhe më tej, nga ana e AKBN-së është rekomanduar aplikimi i penaliteteve për mos respektim të afatit të përfundimit të punimeve sipas përcaktimeve në marrëveshje, por nga ana e OSHA-së nuk është vepruar. Mos penalizimi i koncesionarit për mos respektim të afateve të zbatimit të punimeve është në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, neni 25, pika 2.

- Sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 547, datë 09.08.2006 “Për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, e ndryshuar, AKBN është ngarkuar me detyrën e monitorimit të hidrocentraleve (HEC). Megjithatë, në zbatim të këtij vendimi nuk rezultoi të jetë miratuar ndonjë akt nënligjor, rregullor apo manual teknik që të detajojë qartë procedurat, përgjegjësitë dhe mënyrën e kryerjes së këtij procesi monitorimi.

- Bazuar në shkresën e AKBN nr. 4215 prot., datë 04.10.2024, drejtuar MIE, rezultoi se nga ana e koncesionarit janë realizuar disa punime riparuese vetëm në vitin 2024, Këto punime kanë përfshirë mirëmbajtjen e kanalit të derivacionit në një gjatësi prej 135 metrash, riveshjen me beton të arme të një segmenti tjetër prej 166 metrash, si dhe ndërtimin e një ure-kanal pranë kanalit ekzistues me gjatësi 15 metra linearë dhe formë drejtkëndore. Në pjesët e tjera pas tunelit deri tek baseni i presionit nuk janë realizuar punime. Kryerja e këtyre punimeve riparuese pas një periudhe të gjatë nga ndërtimi i veprës, në një masë të kufizuar dhe jo në strukturat kryesore që përbëjnë rrezikshmëri potenciale, është në kundërshtim me Kontratën Koncesionare neni 4 “Detyrimet e koncesionarit”, si dhe VKM-së nr. 147, datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 28, pika 3.

- Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe verifikimi në objekt rezulton se fuqia e instaluar për HEC Sasaj është 8600 kW. Referuar përcaktimeve të nenit 3 të kontratës koncesionare, fuqia e projektuar dhe e miratuar për këtë veprë është 5,500 kW. Ky devijim nga përcaktimet e kontratës përbën shkelje të drejtpërdrejtë të marrëveshjes koncesionare dhe shoqërohet me problematika të natyrës teknike, të cilat ndikojnë në funksionimin optimal të veprës.

Mungesa e monitorimit gjatë fazës së zbatimit të punimeve ka krijuar hapësirë për shmangie të tilla, të cilat janë të pa riparueshme apo të pamundura për t’u korrigjuar pas vënies në funksion të veprave. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, neni 3.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të kërkojnë nga koncesionarët verifikimin me detaje të strukturave të HEC-eve, si për dëmtime të dukshme, ashtu edhe për vendosjen e aparaturave që paralajmërojnë lëvizje, ulje, zhvendosje apo fenomene të tjera, të cilat çojnë në dëmtim të tyre, në mënyrë që të merren masat paraprake për të parandaluar shembjen e tyre dhe shmangien e rrezikshmërisë që paraqesin këto struktura.

- Nga ana e AKBN të merren masa për monitorime të vazhdueshme të HEC-eve, proces i cili kërkon plotësimin e sektorit përkatës me specialistë të fushës, si dhe burime financiare të mjaftueshme, në mënyrë që monitorimi i marrëveshjeve/kontratave koncesionare të realizohet në mënyrë sa më të plotë, duke parandaluar edhe ngjarje me pasoja të konsiderueshme, për vetë rrezikun që paraqesin vepra të tilla dhe veçanërisht digat, si pjesë përbërëse e këtyre hec-eve.

- AKBN në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të marrin masa për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara, si për pronën publike ashtu dhe atë private, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e koncesionit.

- Nga ana e AKBN të rritet monitorimi i marrëveshjeve koncesionare në lidhje me hedhjen në shtratet ekzistuese të lumenjve të sasisë së ujit ekologjik, sidomos në periudha të thata, me synim eliminimin e problematikave mjedisore dhe shmangien e dëmeve që u bëhen banorëve të zonave përkatëse.

- Nga ana e AKBN-së, për marrëveshjet koncesionare në fazë zbatimi të punimeve, të merren masa për propozimin dhe aplikimin e penaliteteve, sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse.
- Nga ana e AKBN të merren masa për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga koncesionari në fazën ndërtimore, me qëllim sigurimin e respektimit të kuadrit ligjor në fuqi, të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve. Gjithashtu, të marrë masa për forcimin e mekanizmave të monitorimit për ndjekjen dhe vlerësimin e përputhshmërisë së punimeve me afatet e përcaktuara në kontratat koncesionare.
- Nga ana e AKBN-së, të merren masa për hartimin e një rregulloreje apo metodike të detajuar për monitorimin e hec-ve, duke i dhënë prioritet veprave që paraqesin rrezikshmëri, por dhe elementeve të tjerë që përcaktohen si detyrime të koncesionarëve nga marrëveshjet përkatëse, si dhe aktet ligjore e nënligjore.
- Nga ana e AKBN duhet të bëhen monitorime të vazhdueshme në lidhje me masat që duhet të marrin koncesionarët pas vënies në shfrytëzim të veprave. Ky monitorim duhet të përfshijë jo vetëm mirëmbajtjen periodike të infrastrukturës ekzistuese, por edhe investimet e domosdoshme për garantimin dhe rritjen e sigurisë teknike të digave dhe veprave të tjera përbërëse të HEC-eve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet teknike në fuqi.
- Nga ana e AKBN të merren masa dhe t'u kërkohej koncesionarëve paraqitja e dokumentacionit të plotë teknik dhe ligjor, sipas marrëveshjeve koncesionare të nënshkruara, me synim përcaktimin e fushave me risk të lartë për dëmtime dhe rritjen e monitorimit mbi bazën e këtyre përcaktimeve.
- Nga ana e AKBN, të merren masa për monitorimin e respektimit të marrëveshjeve koncesionare që në fazat e zbatimit, si sa i takon respektimit të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, ashtu edhe sa i takon elementëve të tjerë si instalimi i fuqisë së projektuar, duke propozuar dhe aplikuar penalitetet e përcaktuara në këto marrëveshje.

3. Konkluzioni i auditimit.

Baseni i presionit të HEC “Sasaj” Sarandë, është dëmtuar si pasojë e mos respektimit të dispozitave ligjore për realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e tij.

Nga verifikimi i realizuar mbi zbatimin e marrëveshjes koncesionare për HEC “Sasaj” Sarandë janë konstatuar një sërë problematikash sistematike në të gjitha fazat e projektit nga projektimi dhe ndërtimi, deri në fazën e operimit dhe mirëmbajtjes. Në mënyrë të përsëritur, koncesionari nuk ka respektuar kushtet teknike të kontratës, afatet e përcaktuara dhe detyrimet ligjore për raportim dhe dokumentacion, duke përfshirë edhe mosrespektimin e fuqisë së projektuar, mungesën e dokumentacionit teknik të plotë, si dhe neglizhencën në sigurimin e strukturave kryesore, veçanërisht të basenit të presionit, dëmtimi i të cilit solli pasoja të konsiderueshme në mjedis dhe komunitet.

Nga ana tjetër, roli monitorues i AKBN-së ka qenë i pamjaftueshëm, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, fondeve të nevojshme dhe mungesës së akteve rregullatore apo metodologjive të detajuara për mbikëqyrje efektive. Kjo ka sjellë si pasojë mospërmbushjen e detyrimeve ligjore dhe nënligjore nga vetë autoriteti përgjegjës, duke lejuar devijime të pidentifikuara në kohë dhe në mungesën e veprimeve parandaluese dhe korrigjuese.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 131/1, datë 20.01.2025, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 20.01.2024 deri më datë 21.02.2025, në subjektin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

(AKBN), për periudhën nga fillimi i koncesionit deri më 31.01.2025, u krye auditimi mbi përputhshmërinë “Mbi monitorimin e HEC Sasaj, Sarandë”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.T
2. A.M
3. L.K
4. B.K
5. A.H

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Objekt i këtij auditimi përputhshmërie është, të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “Kriteret e vlerësimit”. Ky auditim ka si qëllim:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla etj.
- Aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe korrektësisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik), referuar ISSAI/IFPP 4900 të INTOSAI-t.
- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikohen strukturat dhe personat përgjegjës për veprimet e tyre.

2. Identifikimi i çështjes.

Referuar objektit të auditimit, u identifikuan çështjet për auditim si më poshtë:

- Mbi marrëveshjen koncesionare për HEC “Sasaj”, shtesat dhe ndryshimet, leje dhe autorizime, sigurime, etj.
- Mbi monitorimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të shoqërisë koncesionare për të gjitha fazat e ndërtimit dhe të operimit të HEC “Sasaj”, si dhe propozime dhe aplikime penalitetesh, për mos zbatim të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore.
- Mbi masat e marra nga ana e Koncesionarit në lidhje me sigurinë e digës dhe të veprave të tjera të HEC “Sasaj”. Raporti i shfrytëzimit dhe gjendjes së strukturave të HEC-it, si dhe i punimeve të mirëmbajtjes.
- Mbi pasojat e shkaktuara nga dëmtimi i digës së ujëmbledhësit të HEC Sasaj dhe masat e marra për rikuperimin e tyre.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Marrëveshja e koncesionit përcakton përgjegjësitë e koncesionarit si më poshtë:

- Të projektojë dhe të ndërtojë këtë hidrocentral konform standardeve të përparuara bashkëkohore.
- Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive koncesionare.
- Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t’u shkaktohet palëve të treta.

- Të mbajë të informuar ministrinë për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit.
- Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha dispozitat ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për marrëdhëniet e punës.
- Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi. Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë. Të realizojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm.
- Të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit dhe përdorimit të tyre nga shoqëria koncesionare
- Të përjashtojë çdo lloj përgjegjësie të ministrisë, përpara parashikohet në këtë nen, për dëmet, dëmtimet dhe të tjera që mund t'i ndodhin Koncesionarit dhe punonjësve të tij gjatë periudhës së koncesionit, etj.

AKBN është përgjegjëse për:

- Konsultimin, propozimin dhe bashkëpunimin me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të energjetikës.
- Zbatimin e politikave të qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe energjetike.
- Sigurimin, brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore a private, vendase ose të huaja. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;
- Mbikëqyrjen e veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike.
- Monitorimin e kontratave koncesionare për hidrocentralet.
- Kryerjen, brenda fushës së veprimtarisë së vet, të oponencës teknike për projektet e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, sipas tarifave të përcaktuara me përjashtim të oponencës teknike për punimet e ndërtimit, që kryhet nga institucionet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Ndjekjen e procesit të vlerësimit të investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, në bashkëpunim me ekspertë vlerësues të pavarur, të caktuar nga ministri përgjegjës për sektorin e energjisë. Autoriteti kontraktues miraton raportin përfundimtar të vlerësimit, etj.

4. Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara ligjore, pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion të përgjithshëm. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

5. Kriteret e vlerësimit.

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t: ISSAI 400;
- Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”; ISSAI 100 “Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të IFAC;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;
- Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH etj.
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” me ndryshimet deri në vitin 2010.
- Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me ndryshime.
- Ligji nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” i ndryshuar.
- Ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
- Ligji nr. Nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i ndryshuar.
- Rregullore në mbështetje të ligjit të mësipërm nr. 147, datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”.
- VKM nr. 27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar.
- VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar etj.
- VKM nr.501, datë 23.7.2004 “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO”, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA) dhe shoqërisë “W” sh.a., për ndërtimin e hidrocentralit të Sasajt”.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: ISSAI/IFPP 100 “Parimet bazë në auditimin e sektorit publik”, ISSAI/IFPP 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”, ISSAI/IFPP 4000-4899 & 4900 “Udhëzues mbi kornizën ligjore dhe kriteret që do të merren parasysh gjatë shqyrtimit të aspekteve të rregullshmërisë dhe përshtatshmërisë në auditimin e përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI 140 “Sigurimin e cilësisë”

ISSAI 130 “Kodin Etik”

ISSAI 2315 “Risku”

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

7. Metodatat e auditimit.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, nga grupi i auditimit janë aplikuar:

- Verifikimi i transaksioneve, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre, me qëllim sigurimin e një evidence auditimi të saktë, të plotë, të përshtatshme për të bazuar konkluzionet dhe dhënien e opinionit të auditimit;
- Intervistimi, është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.

8. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 7, datë 17.01.2024, Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat. Nga grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera prej tij.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Baseni i “HEC Sasaj, Sarandë”, ka pësuar dëmtime në strukturën e basenit të presionit, duke e nxjerrë jashtë pune njësinë e prodhimit të energjisë dhe duke shkaktuar dëme palëve të treta. Nga auditimi rezulton se gjatë ndërtimit nuk janë respektuar dispozitat ligjore në lidhje me ndjekjen e punimeve, hartimin e situacioneve të punimeve, realizimin e investimit të parashikuar për të gjitha elementët. Gjatë vënies në funksion dhe gjatë prodhimit, nga ana e koncesionarit për një periudhë të konsiderueshme nuk janë bërë investime për mirëmbajtjen e veprave, apo rritjen e elementëve të sigurisë. Në mënyrë periodike nga ana e Koncesionarit nuk është raportuar për masat që duhen marrë, për sigurimet e aseteve apo elementë të tjerë të detyrueshme për raportim. Pavarësisht tërheqjes së vëmendjes nga ana e AKBN, jo vetëm për këtë koncesionar por dhe për të tjerë, nuk janë respektuar kërkesat ligjore në këtë drejtim. Në vazhdimësi, por në mënyrë më të theksuar gjatë vitit 2022, nga ana e koncesionarit nuk është lëshuar sasia e ujit ekologjik në rrjedhën e lumit ekzistues, duke krijuar pasoja për mjedisin, por edhe për banorët e zonës, nga mungesa e ujit për ujitje. Në momentin e auditimit, nga ana e MIE por dhe AKBN nuk disponohet informacion mbi masat e marra për identifikimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga palët e treta.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Mbi auditimin e ushtruar mbi marrëveshjen e koncesionit për HEC “Sasaj”, shtesat dhe ndryshimet, leje dhe autorizime, sigurime, etj.

Me VKM Nr. 634, datë 18.09.2003 është miratuar fillimi i procedurës së ndërtimit me Koncesion të formës ”BOO”, të Hidrocentralit të Sasajt dhe me VKM Nr. 501, Datë 23.07.2004, është miratuar Marrëveshja e Koncesionit për Ndërtimin e Hidrocentralit të Sasajt e formës “BOO”, lidhur ndërmjet METE, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA), dhe Konsorciumit të shoqërive të projektit të Sasajt.

Hidrocentrali i Sasajt shtrihet në pjesën Jug - perendimore të vendit buzë detit Jon, në rrugën automobilistike Vlorë – Sarandë, në largësi rreth 20 km nga Saranda. Aksi i Hidrocentralit të Sasajt vendoset në një kodër në VP të fshatit Lukovë, dhe zhvillohet përgjatë proit të Bunecit, në faqen e orientuar perballë Sasajt. Ky hidrocentral është i tipit me derivacion, ka fuqi të vendosur 8000 kW (2x4000 kW) dhe prodhim mesatar vjetor energjie prej 38 milion kWh, e

llogaritur kjo duke zbritur prurjen në periudhën e ujitjes. Prurja e ujit është 3.2 m³/sek dhe rënia llogaritëse 217 m. Vepra është ndërtuar në vazhdim të veprës së marrjes në lumin e Kalasës, kanalit të derivacionit, tunelit të Sasajt të ndërtuar më parë.

Me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 35468 datë 11.04.2006, u legalizua Shoqëria Koncesionare “E.-S.” Sh.p.k. e krijuar me 05.09.2004, e cila kryen ndërtimin si dhe veprimtarinë operatore të Hec Sasaj. Kompania “E.-S.” është shoqëri aksionere ku Kompania A. G. zotëron aksionet e veta.

Me Vendim Nr.11/6, datë 10.07.2006 të KRRT të Komunës Lukovë është miratuar destinacioni i Sheshit të Ndërtimit për Gjurmën e Hec Sasaj. Është marrë miratimi i Këshillit të Komunës dhe komunitetit të banorëve të zonës, sipas Akt-Marrëveshjes midis banorëve të fshatit Sasaj dhe shoqërisë “E.-S.”, të datës 26.11.2008, ku jepet pëlqimi i banorëve të këtij komuniteti për ndërtimin e hidrocentralit në tokat e fshatit Sasaj.

Me shkresë Nr.427 Prot. Datë 01.08.2007 dhe me vendim nr. 9 të Komisionit të Lejeve është akorduar Leja Mjedisore për shoqërinë “E.-S.” Sh.p.k. për “Ndërtim dhe Funksionim Hidrocentrali” nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Me Vendim Nr. 6, datë 04.12.2006, është miratuar Leja e Përdorimit të Ujit të burimeve të Tatzatit, për Hec Sasaj dhënë subjektit “E.-S.” Sh.p.k. nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës “Vjosë” Vlorë, e rinovuar si leje me datë 21.07.2022 dhe e vlefshme deri me datë 29.07.2034.

Me Vendim Nr. 83 datë 27.11.2006 të ERE, është dhënë Liçensa për Ndërtimin, Instalimin dhe Prodhimin e Energjisë nga Hidrocentrali Sasaj, për subjektin “E.-S.” sh.p.k.

Në këtë mënyrë ky projekt ka plotësuar të gjithë kuadrin ligjor dhe është pajisur me lejen e ndërtimit në janar të vitit 2009, kur kanë filluar punimet e ndërtimit të veprës.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, Koncesionari është siguruar tek Kompania “S. U. G. A.” për periudhun nga 21.08.2024 deri me 20.08.2025, me policë sigurimi nr.12/GJSG4/196526.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është ent publik me seli në Tiranë e krijuar sipas VKM Nr. 547, datë 9.8.2006, i ndryshuar, nga bashkimi i Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve, Institutit të Studimeve dhe Projektive të Metalurgjisë, Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve dhe Institutit të Studimeve dhe Projektive të Mekanikës dhe Drurit dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë. Ky institucion është në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe ka si objekt të punës së tij zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik. Struktura, organika dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përcaktohen në statut-rregulloren e kësaj agjencie, e cila miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës.

Bazuar në sa më sipër, disa nga detyrat funksionale të AKBN, paraqiten si më poshtë:

- Konsulton, propozon dhe bashkëpunon me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të energjetikës;
- Zbaton politikat e qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe energjetike;
- Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore a private, vendase ose të huaja. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;
- Mbikëqyr veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;
- Monitoron kontratat koncesionare për hidrocentralet.
- Kryen, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën teknike për projektet e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, sipas tarifave të përcaktuara me përfundim të oponencës

teknike për punimet e ndërtimit, që kryhet nga institucionet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Ndjek procesin e vlerësimit të investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, në bashkëpunim me ekspertë vlerësues të pavarur, të caktuar nga ministri përgjegjës për sektorin e energjisë. Autoriteti kontraktues miraton raportin përfundimtar të vlerësimit, etj.

Nga auditimi i dosjes Hec Sasaj konstatohen disa mungesa në dorëzimin e dokumentacionit, sic janë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Nuk janë në vazhdimësi të dorëzuara kontrata e certifikimit të veprës të përshtatshme për sigurimin për të mbuluar çdo risk të mundshëm. Është dorëzuar vetëm një kontratë e vlefshme për vitin 2016-2017 Polica Nr 12/GJSG4/0086928 e lidhur me kompanin “S. U. G. A.”.

Një kontratë sigurimi për periudhën 21.08.2024 deri me 20.08.2025, me nr.12/GJSG4/196526, e lidhur me kompaninë “S. U. G. A.”, i është paraqitur grupit të auditimit nëpërmjet email. Kjo kontratë nuk gjendet e arkivuar në dosjen e Hec Sasaj në AKBN.

Kontrata e Koncesionarit e formes “BOO” Nr.501, datë 23.7.2004 e përcakton në mënyrë shteruese në Neni 4/ Detyrimet e Koncesionarit dhe në Neni 15/ Sigurimet. Koncesionari nuk ka dorëzuar pranë AKBN, kopjet e certifikuara të çdo certifikate sigurimi, në kundërshtim me Nenin 4 dhe Nenin 15 të Kontratës së Koncesionarit e formës “BOO”.

Drejtoria e Monitorimit të Kontratave Koncesionare të HEC-ve nuk ka arritur të marrë cdo vit kontratat e siguracioneve. Kjo bie në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në “Rregulloren e Brëndshme” të AKBN sipas VKM- së (Nr.822 , e vitit 2015).

Nga shqyrtimi i dosjes HEC Sasaj, konstatohet se dokumentacioni nuk është inventarizuar e arkivuar, si dhe dokumentacioni që përmbajnë dosjet është pjesërisht fotokopje. Sa më sipër në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”. Ligji nr. 27/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “për arkivat”, punonjësi i rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë të administratës shtetërore qendrore e vendore, duhet të respektojë Kodin Deontologjik Ndërkombëtar të Arkivistëve.

2.2. Mbi monitorimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të shoqërisë koncesionare për të gjitha fazat e ndërtimit dhe të operimit të HEC “Sasaj”, si dhe propozime dhe aplikime penalitetesh, për mos zbatim të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore.

Në VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, pika 2, përcaktohet: “*Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka objekt të veprimtarisë zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik*”.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, për HEC Sasaj janë realizuar 9 raporte monitorimi të cilat i përkasin viteve 2010, 2011, 2012, 2016, 2020 dhe 2023.

- Ne vitin 2010 janë kryer 2 monitorime që i përkasin 6-mujorit të parë dhe tremujorit të tretë të këtij viti.
- Ne vitin 2011 janë kryer vetëm një monitorim në tremujorin e parë.
- Ne vitin 2012 janë kryer 2 monitorime që i përkasin tremujorit të parë dhe tremujorit të dytë të këtij viti.
- Ne vitin 2013 nuk ka dokumentacion që veteton kryerjen e monitorime.
- Ne vitin 2014 është kryer 1 monitorim që i përket tremujorit të parë.
- Ne vitin 2015 nuk ka dokumentacion që veteton kryerjen e monitorime.
- Ne vitin 2016 është kryer 1 monitorim që i përket tremujorit të tretë.
- Ne vitet 2017, 2018 dhe 2019 nuk ka dokumentacion që veteton kryerjen e monitorime.
- Ne vitin 2020 është kryer 1 monitorim që i përket gjashtëmujorit të parë.

- Ne vitet 2021 dhe 2022 nuk ka dokumentacion që veteton kryerjen e monitorime.
- Ne vitin 2023 është kryer 1 monitorim që i përket gjashtëmujorit të parë.

Bazuar në raportin e monitorimit për 6-mujorin e parë të vitit 2010, AKBN me shkresë nr. 495 prot., datë 02.03.2010, i ka kërkuar koncesionarit dokumentacion teknik që ka të bëjë me procesverbalin e fillimit të punimeve, kontratën e lidhur me mbikëqyrësin e punimeve dhe licencën përkatëse, raportin periodik 3 mujor në lidhje me ecurinë e punimeve, certifikatat e materialeve të përdorura, si dhe situacionet e punimeve. Nga ana e koncesionarit janë paraqitur vetëm disa situacione punimesh, pa nënshkrimin e ndonjë mbikëqyrësi të punimeve. Koncesionari gjithashtu nuk ka paraqitur në AKBN policat e sigurimit. Në konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti përcaktohet: “Koncesionari duhet të kishte përfunduar ndërtimin e HEC brenda 40 muajve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, ose brenda datës 18.02.2007, por punimet janë në fazën fillestare të tyre. Bazuar në nenin 25, pika 2, të marrëveshjes së koncesionit, **për vonesë në vënien në punë të hidrocentralit dhe kur kanë kaluar më shumë se 60 ditë vonesë, Koncesionari duhet të penalizohet me 0.01 % të vlerës së investimit të pa realizuar për cdo ditë vonesë. METE duhet të njoftojë koncesionarin për këtë shkelje dhe të presë një periudhë 60 ditore dhe mbi bazën e përgjigjes, vendos apo jo fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës së koncesionit.**

Bazuar në raportin e monitorimit për 6 mujorin e dytë të vitit 2010, përcaktohet se koncesionari nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar madje as projektin e zbatimit. Nga monitorimi i ecurisë së punimeve është vlerësuar se koncesionari ka realizuar investimin në masën 1.7 %. Edhe në këtë raport i rekomandohet METE që të njoftojë koncesionarin mbi shkeljen e afateve në marrëveshje për përfundimin dhe vënien në punë të HEC, pritjen e një periudhe 60 ditore dhe në bazë të përgjigjes të fillojnë procedurat për zgjidhjen e kontratës së koncesionit. Koncesionari nuk ka paraqitur një sërë dokumentesh të kërkuara.

Bazuar në raportin e monitorimit për 6 mujorin e parë të vitit 2011, me shkresë nr. 353 prot., datë 07.02.2011, AKBN i ka përsëritur koncesionarit kërkesën për paraqitjen e dokumentacionit të HEC. Kërkesa ndër të tjera ka të bëjë me dokumentacionin e sigurimit të kontratës, sigurimin e objekteve në ndërtim, financimin e objekteve, kopje të kontratave të punës etj., por nuk është marrë përgjigje. Edhe në këtë raport rekomandohet që në bazë të nenit 25 të kontratës së koncesionit, koncesionari duhet të penalizohet në masën 0.01 % të vlerës së investimit të pa realizuar, për çdo ditë vonesë.

Bazuar në raportin e monitorimit për 3 mujorin e parë të vitit 2012, nga ana e koncesionarit është paraqitur dokumentacioni i cili ka të bëjë kryesisht me regjistrimin në organin tatimor, ekstraktin e QKR, licencën nga ERE, Vendimin e KRRTRSH, Vendimin e KRRT të ish-Komunës Lukovë, leje për përdorimin e rezervës ujore, leje mjedisore etj. Në këtë raport cilësohet se bazuar në nenin 10 të marrëveshjes, koncesionari duhet të vinte në punë HEC Sasaj brenda datës 18.12.2007. Ndërkohë që bazuar në dokumente punimet kanë përfunduar me vonesë.

Në këtë raport ritheksohet se për shkelje të afateve të ndërtimit, duke qenë se nuk është paraqitur ndonjë ndryshim kontrate, koncesionari duhet të penalizohet në masën 0.01 % të vlerës së punimeve të pa realizuara për çdo ditë vonesë.

Bazuar në raportin e monitorimit për 3 mujorin e dytë të vitit 2012, nga data 02-03.08.2012, janë verifikuar punimet e realizuara në objektet përbërëse të HEC sasaj. Në këtë raport cilësohet se vepra e marrjes, dekantuesi, kanali i derivacionit dhe tuneli janë vepra ekzistuese. Baseni i presionit i cili është i pajisur me shkarkues sipërfaqësor dhe fundor, është vënë në shfrytëzim. Baseni i presionit ka një volum 4500 m³ dhe shërben si një rregullator orar. Në momentin e verifikimit baseni i presionit nuk ishte në punë, për arsye se po punohej për pastrimin nga llumrat e precipituara. Në këtë raport vihet theksi i mungesës së dokumentacionit i cili ka të bëjë me aktin e kolauditimit, vizatimet përfundimtare etj. Cilësohet se grupi i monitorimit nuk ka në përbërje topograf dhe se verifikimi realizohet kryesisht në formë vizive. HEC është vënë

në shfrytëzim dhe rekomandohet aplikimi i penaliteteve për vonesa, duke vërtetuar në këtë mënyrë faktin e mos aplikimit të tyre deri në këtë fazë.

Bazuar në raportin e monitorimit për 3 mujorin e parë të vitit 2011, HEC ishte në funksion. Është konstatuar se në tubacionet e turbinave ka këputje të disa bulonëve të ankerimit, për të cilën i është lënë detyrë koncesionarit për riparim të menjëhershëm. Cilësohet se AKBN nuk ka marrë pjesë në testimin e hidrocentralit, veprim i cili duhet të kryhet në kohë me prurje të përshtatshme. Nga ana e koncesionarit nuk është paraqitur dokumentacion mbi bilancin energjistik, dokumentacion i cili duhet të paraqitet çdo tre muaj i rakorduar me KESH SHA.

Me shkresën nr. 1061/7 datë 09.05.2013 Sekretari i Përgjithshëm i METE-es, urdhëron AKBN për ngritjen e një grupi kontrolli “Për testimin e Hec Sasaj”. Shoqëria koncesionare “E. -S.” shpk me shkresën nr. 3415/1 dt. 20.05.2013, kundërshton kontrollin zyrtar pranë HEC Sasaj dhe njofton AKBN dhe METE se Asambleja e Ortakëve të shoqërisë “E.-S.” më datë 11.08.2012, ka vendosur kryerjen e një auditi të brendshëm tre-vjecar, lidhur me verifikimin e investimit të kryer në projekt dhe nëse ka qënë në përputhje me projektin ose jo. Gjithashtu nëpërmjet kësaj shkrese njoftohet se administrator i ri është vendosur z. V. N. Në këto kushte shoqëria kërkon pezullimin e çdo kontrolli nga ministria deri në përfundim të auditit dhe zbardhjes së situatës. Shoqëria ka përsëritur kërkesën e saj me shkresën nr. 3415/3, datë 28.05.2013, për pezullim të kontrollit nga METE deri në përfundim të auditit të brendshëm duke bërë të ditur se nuk do të pranojë asnjë raport zyrtar nga AKBN dhe se cdo raport zyrtar do të jetë subjekt i ndjekjes ligjore. Koncesionari referuar po të njëjtës shkresë shprehet se do të mbajë të gjitha përgjegjësitë për mospërbushjen e detyrimeve kontraktuale me METE.

Bazuar në raportin e monitorimit për 3 mujorin e tretë të vitit 2016, HEC Sasaj është në funksion të plotë dhe pa ndonjë mangësi të konstatuar sa i përket këtij funksionimi. Cilësohet se për këtë Hidrocentral është mbyllur investimi nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Nga monitorimi i kryer në terren më datë 20.09.2016, është konstatuar se në përgjithësi veprat e HEC-it ishin të mirëmbajtura dhe në gjendje pune.

Bazuar në raportin e monitorimit për 6 mujorin e parë të vitit 2016, nga ana e koncesionarit nuk janë paraqitur policat e sigurimit.

Bazuar në raportin e monitorimit për 6 mujorin e parë të vitit 2023, për këtë HEC rezulton të jetë kryer mbyllja e investimit në vitin 2013 me grup të përbashkët AKBN, MEI, MBU dhe MM. Për sa i përket prodhimit të energjisë, për vitin 2023 prodhimi i energjisë nga ana e kësaj shoqërie ka qënë 23,000,000 këh. Hidrocentrali ndodhet në fazën e prodhimit të energjisë elektrike. Koncesionari ka informuar në lidhje me lejen për përdorim të burimit ujor lëshuar nga KBU Vjosë me Nr.12/7 Dt.29.07.2022.

Referuar raportit të monitorimit të kryer në datë 12.07.2023 rezulton se: - në aktin e monitorimit pasqyrohen të dhëna të përgjithshme por nuk përshkruhen të dhëna të detajuara lidhur me gjendjen e konstatuar sipas elementeve që përbëjnë si: Veprat e marrjes; Tubacioni i turbinave; Dekantuesi; Derivacioni; Makineri pajisje.

Në lidhje me basenin e presionit është cituar: ***Baseni i presionit është funksional, i pajisur me porta komandimi, zgarë metalike.***

Me shkresën nr 836/2, datë 28.09.2023 AKBN i është drejtuar shoqërisë “E. S.” lidhur me mos zbatimin e detyrimit të nenit 19 të kontratës koncesionare për raportimin me shkrim tek autoriteti kontraktor cdo 6-muaj.

Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se:

Nga ana e AKBN nuk janë realizuar monitorime të mjaftueshme për HEC Sasaj, veprim jo në përputhje me VKM nr. 547, datë 09.08.2006 me ndryshime “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” dhe VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”.

- Nga ana e koncesionarit nuk janë respektuar afatet për ndërtimin dhe venien në shfrytëzim të HEC Sasaj, në kundërshtim me Marrëveshjen e Koncesionit, neni 11, ku përcaktohet: *“Koncesionari merr përsipër të përfundojë projektzbatimin brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.*

Koncesionari merr përsipër të fillojë punën brenda 20 (njëzet) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Koncesionari merr përsipër të përfundojë këtë hidrocentral brenda 40 (dyzet) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje”.

- Nga ana e AKBN është rekomanduar për aplikimin e penaliteteve për mos respektim të afateve nga ana e koncesionarit, megjithatë nuk ka patur reagim nga ana e MIE, në kundërshtim me Marrëveshjen e Koncesionit, neni 25, ku përcaktohet: *“Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizon palët sipas detyrimeve të marra prej tyre, me vendim të gjykatës së mësipërme. Në rast vonesash në realizimin e projektit, të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 11, kur kanë kaluar më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë vonesë, Koncesionari detyrohet të paguajë MIE për çdo ditë vonesë penaltetin prej 0.01% të vlerës së investimit të përcaktuar”.*

- Nga ana e koncesionarit nuk është vepruar me dërgimin e dokumentacionit gjatë fazës së koncesionit, në kundërshtim me Marrëveshjen e Koncesionit, neni 19, par. 2, ku përcaktohet: *“Koncesionari është i detyruar që çdo gjashtë muaj të raportojë me shkrim pranë MIE, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas prodhimin e energjisë elektrike”.*

- Nga ana e AKBN nuk është realizuar monitorimi i duhur si në fazën e përgatitjes, të ndërtimit apo të prodhimit të HEC sasaj, në mospërputhje me:

- VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, i ndryshuar, pika 3, ku përcaktohet:

“Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka objekt të veprimtarisë... ‘Mbikëqyrje veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike’”.

- Marrëveshjen e Koncesionit, neni 19, par. 1, 3 dhe 4, ku përcaktohet: *“MIE ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.*

MIE ruan të drejtën që gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar se dispozitat e koncesionit do të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

MIE mund të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, ashtu si cilësia dhe konformiteti, të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit”.

Megjithëse në VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, është përcaktuar se AKBN kryhen monitorimin e HEC-ve nuk rezulton e miratuar ndonjë akt/rregullore/manual ku të detajohet procesi i monitorimit të HEC-ve.

Në këtë rast ka munguar në afat kjo korrespondencë e përcaktuar në VKM 547/2006 e ndryshuar, kjo edhe për arsye të mungesës së fondeve dhe stafit të AKBN të nevojshëm për përfshirjen në monitorim të HEC-ve që janë në fazën e prodhimit të energjisë.

Në marrëveshjen Koncesionare të miratuar me VKM nr. 501, datë 23.07.2004 në neni 19, përcaktohet se: Koncesionari çdo 6-muaj duhet të raportojë me shkrim tek Organi Shtetëror i autorizuar (MIE), realizimin e programit të investimit në vlerë e natyrë dhe më pas lidhur me prodhimin e energjisë. Në këtë rast ka munguar në afat kjo korrespondencë e përcaktuar në VKM 501/2004.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. M. H., z. E. Sh., z. I. B., z. A. H., z. A. L., z. A. Ç. dhe z. E. M., në cilësinë e përgjegjësve të sektorit të monitorimit të HEC-eve, sipas periudhave përkatëse.

2.3. Mbi masat e marra nga ana e Koncesionarit në lidhje me sigurinë e digës dhe të veprave të tjera të HEC “Sasaj”. Raporti i shfrytëzimit dhe gjendjes së strukturave të HEC-it, si dhe i punimeve të mirëmbajtjes.

Nga auditimi konstatohet që:

a. Mbi zbatimin e marrëveshjes së koncesionit.

Kontrata e koncesionit është nënshkruar ndërmjet OSHA, i cili është Organi Shtetëror i Autorizuar (MIE) dhe Shoqërisë “W.” SHA dhe është miratuar me VKM nr. 501, datë 23.07.2004.

Në nenin 2, të kësaj marrëveshje “Objekti i koncesionit”, përcaktohet: “E drejta që OSHA i ka dhënë koncesionarit, për përdorimin e kanalit ekzistues nga burimi deri tek tuneli me gjatësi rreth 1.2 km, tuneli me gjatësi rreth 2.35 km dhe kanalit ekzistues 3.53 km mbas tunelit, për vendin e parashikuar në projekt për basenin me presion me kapacitet 12000 m³, për vendin e parashikuar në projekt për tubacionin e turbinës me gjatësi 810 ml, për vendin e parashikuar në projekt për kapërderdhësin anësor, ndërtesën e centralit, nënstacionin 35 kV, kanalim me gjatësi 60 ml, pra veprën hidroenergjetikë të kompletuar”.

Akti i dorëzimit të zonës së koncesionit të ndërtimit të HEC Sasaj-Sarandë, ndërmjet OSHA (MIE dhe MBUMBK) dhe Koncesionarit “W.” SHA, është mbajtur me datë 01.06.2006.

Në ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i ndryshuar, përcaktohet:

- Në nenin 3 “Fusha e veprimit”, përcaktohet: *“Ky ligj ka fuqi vepruese në të gjitha digat/dambat, që ndërtohen të reja ose janë në shfrytëzim, të shtrira në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:*

a. Lartësia e digës/dambës të jetë mbi 15 metra.

b. Lartësia e digës të jetë 10 deri 15 metra kur:

- vëllimi i ujit të grumbulluar është mbi 1 hm³ (një milionë m³) ujë;

gjatësia e kurorës është mbi 500 metra.

c) Çdo digë/dambë tjetër, që nuk plotëson kushtet në pikat "a" dhe "b", përbën rrezik për të "tretët".

Në kuptim të përcaktimit të mësipërm ligjor, baseni i presionit të HEC Sasaj i cili është dëmtuar me datë 16.01.2025, klasifikohet sa i takon rrezikut për të tretët.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, në mënyrë të vazhdueshme, koncesionari nuk i është përgjigjur AKBN për dhënie informacioni për fazën e zbatimit të punimeve, por dhe në fazën e operimit.

METE me shkresë nr. 2678/1 prot., datë 20.04.2010, ka njoftuar gjithë shoqëritë koncesionare për HEC-et, për shqetësimin e ngritur nga AKBN, për mos informimin dhe mos paraqitje të dokumentacionit të kërkuar, duke vështirësuar monitorimin e HEC-ve. Nga ana e AKBN i është kërkuar paraqitja e dokumentacionit juridik, teknik dhe financiar me shkresë nr. 495 prot., datë 02.03.2010, nr. 806 prot., datë 05.04.2010, nr. 1258 prot., datë 19.05.2010, nr. 1944 prot., datë 27.07.2010, nr. 3165 prot., datë 24.11.2010 etj.

AKBN me shkresë nr. 1043 prot., datë 23.04.2010, drejtuar Shoqërisë “E.-S.” sh.p.k, ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor deri me datë 31.05.2010, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratën koncesionare. Në pikën 5, të kësaj shkrese përcaktohet se në mungesë të dokumentacionit, AKBN do t’i propozojë Autoritetit Kontraktues aplikimin e sanksioneve përkatëse deri në zgjidhjen e njëanshme të kontratës së koncesionit.

Me Urdhër të Ministrit të METE nr. 834, datë 25.10.2011, është ngritur një grup pune për verifikimin e investimit, testimin dhe vënien në punë të HEC Sasaj, të përbërë nga z. Xh. T. (përfaqësues METE), z. A. K. dhe z. S. S. (përfaqësues AKBN), z. Sh. Xh. dhe z. A.O.

(përfaqësues i MBUMK). Shoqëria "E.-S." sh.p.k me shkresë nr. 118/1 prot., datë 27.12.2010, i ka kthyer përgjigje AKBN, duke paraqitur edhe 21 situacione pjesore punimesh. Për periudhën nga data e fillimit të punimeve deri me datë 30.01.2010, situacionet e punimeve të paraqitura nga janë të certifikuar nga ndonjë mbikëqyrës punimesh. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se deri me datë 30.10.2011, janë paraqitur 34 situacione pjesore punimesh me vlerë 441,355,469 lekë me TVSH, ose realizim në masën 64 % të punimeve. Pas kësaj date janë paraqitur edhe 8 situacione pjesore me vlerë 246,488,874 lekë me TVSH. Bazuar në situacionet e paraqitura, vlera e realizuar e investimit paraqitet në shumën 687,844,343 lekë. Situacionet nga fillimi i punimeve deri me datë 16.09.2011 (situacion 1 deri 31), janë nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve z. Dh. L., po ashtu situacionet 33 dhe 34, ndërsa situacionet 32, 35, 36, 37 dhe 38, janë nënshkruar nga dy mbikëqyrësit e punimeve. Situacionet 39.1, 39.2, 39.3 dhe 39.4, që i përkasin punimeve nga data 24.12.2011 deri me datë 03.10.2012, janë nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. K.

Nga sa më sipër konstatohet se nuk ka një emërim të qartë të mbikëqyrësve të punimeve. Në disa situacione nënshkruajnë dy mbikëqyrës punimesh dhe në të tjera, vetëm njëri. Koncesionari ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, kap. 1, pika 14, ku përcaktohet: *"Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij"*.

Konstatohet se situacionet pjesore janë të dubluara, ndër të cilat njëri është me nënshkrimin dhe tjetri pa nënshkrim të mbikëqyrësit të punimeve. Nëse marrim në konsideratë situacionin nr. 6, njëra kopje ka datën 05.10.2009 ndërsa tjetra 10.11.2009. Pavarësisht se vlera e tyre është e njëjtë, zërat përbërës kanë ndryshime. Në njërin situacion përcaktohet "F.V tubacion metalik 1200/14", me vlerë 5,872,657 lekë, ndërsa në situacionin tjetër "Beton M 300 për bazament turbine me vlerë 5,144,760 lekë. Për zërin "Vendosje tub plastik dren Ø 60", sasia në njërin situacion është 540 ml, ndërsa në tjetrin 240 ml. Po ashtu për situacionin nr. 5 datë 16.08.2009, në dy kopje të ndryshme ka volume të ndryshme, duke vërtetuar në këtë mënyrë mos korrektësinë në raportimin e volumeve të realizuara.

Në procesverbalin e mbajtur me datë 30.10.2011 ndërmjet shoqërisë investitore "E.-S." sh.p.k dhe Shoqërisë sipërmarrëse "W." sh.p.k si dhe mbikëqyrësit të punimeve z. Dh. L., cilësohet se punimet kanë përfunduar me datë 30.10.2011. Vlera e punimeve të realizuara është përshkruar në shumën 695,765,174 lekë. Pavarësisht se punimet janë deklaruar të përfunduara me datë 30.11.2011, pas kësaj date janë paraqitur situacione për punime të realizuara deri me datë 03.10.2012, nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. K., pavarësisht se këto situacione nuk paraqesin punime për veprat kryesore, por punim si për rehabilitim rruge, sistemim skarpatah etj.

Në ndjekjen e punimeve dhe hartimin e situacioneve pjesore dhe përfundimtar është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, kap. 1, pika 14, ku përcaktohet: *"...Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve"*.

Ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësit e punimeve z. Dh. L. dhe z. A. K.

Bazuar në relacionin teknik, hartuar në zbatim të Urdhrit të Ministrit të METE nr. 4762 prot., datë 17.05.2012, shoqëria koncesionare ka dërguar aktin e kolaudimit të punimeve të datës

15.09.2011, të nënshkruar nga sipërmarrësi, investitori, mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori. Në këtë relacion përcaktohet se akti i kolaudit (i cili nuk është pjesë e dosjes teknike në dispozicion të grupit të auditimit), nuk përcaktohet koha e zgjatjes së kolaudit, vlera e objektit e preventivit, vlera e situacionit dhe afati i ndërtimit. Nuk jepen përshkrimet e bëra mbi dokumentacionin e faktin.

Situacioni Përfundimtar, pjesë e dosjes pranë AKBN (i pa nënshkruar) paraqitet me vlerë 695,765,174 lekë.

Nga ana e AKBN nuk janë marrë masa për njoftimin e institucioneve përkatëse për mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e paraqitur nga koncesionari gjatë ndërtimit të HEC Sasaj, edhe pse ky dokumentacion është paraqitur me vonesë, por është mjaftuar me dërgimin e Raportit të Monitorimit në METE.

Bazuar në MEMO nr. 406/2 prot., datë 31.05.2013, të Drejtorisë Juridike pranë AKBN, drejtuar z. S. B., drejtor ekzekutiv i AKBN, ndër të tjera sqarohet:

- Me shkresë nr. 1061/7 prot., datë 09.05.2013, Sekretari i Përgjithshëm i METE urdhëron AKBN për ngritjen e një grupi kontrolli për testimin e HEC Sasaj. Ky kontroll nuk është pranuar nga shoqëria koncesionare me shkresë nr. 3415/1 prot., datë 20.05.2013, ka kundërshtuar kontrollin zyrtar, duke njoftuar AKBN dhe METE se asambleja e ortakëve të shoqërisë "E.-S.", me datë 11.08.2012, ka vendosur kryerjen e një auditi të brendshëm 3-vjeçar, lidhur me investimin e kryer në projekt dhe nëse ka qenë në përputhje me projektin apo jo. Nga ana e koncesionarit nuk është lejuar që grupi i punës të bëjë monitorimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale.

AKBN me shkresë nr. 3415/1 prot., datë 31.05.2013, i ka dërguar Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), një relacion teknik, ekonomik dhe juridik, në lidhje me zbatimin e të gjitha detyrimeve të përcaktuar në kontratë për koncesionarin "W." SHA. Relacioni është hartuar nga z. B. Z. (Drejtoria Hidroenergjitike pranë AKBN), z. P.S. (Drejtoria e Financës pranë AKBN) dhe z. K. J. (Drejtoria Juridike).

Në këtë relacion, ndër të tjera përcaktohet:

- Tek vepra e marrjes konstatohet nevojë e ndërhyrjes dhe riparimeve tek zgara, e cila kryen funksionin e mbrojtjes nga prurjet inerte.

- Tek dekantuesi ish-in krijuar gërryerje të theksuara të mureve, të cilat duhen eliminuar për të shmangur filtrimet e ujit.

- Sa i takon kanalit të derivacionit, rezulton i rehabilituar në gjatësinë më të madhe të tij, është pastruar dhe rehabilituar tuneli si dhe janë rikonstruktuar pjesët hyrëse dhe dalëse të tij.

- Sa i takon basenit të presionit, tubacionit të turbinave dhe godinës së centralit, ato janë ndërtuar të reja.

- Nga krahasimi i preventivit me situacionin përfundimtar rezulton se nuk janë realizuar disa nga punimet e parashikuara si sa i përket rrugës së shërbimit, ka lëvizje të vogla të volumeve të betonit, të sasisë së hekurit etj.

- Bazuar në nenin 3 të kontratës, fuqia e instaluar duhet të ishte 5500 kW. Nga verifikimi në objekt rezulton se fuqia e instaluar është 8600 kW (2 agregate nga 4300 kW secili), pra kushti i fuqisë së instaluar është plotësuar në masën 156 %.

- Për vitin 2012, energjia e prodhuar është 27992050 kW/h, nga 23000000 kW/h të përcaktuar në marrëveshje, ose në masën 21.7 % më tepër nga kontraktimi.

- Koncesionari ka themeluar shoqërinë e re me datë 07.04.2006, jo në afatin e përcaktuar i cili ishte brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes, që përket me datën 18.09.2004.

- Meqenëse afati i ndërtimit dhe vënies në punë të HEC-it ka përfunduar dhe koncesionari nuk ka një marrëveshje me MIE për shtyrje të afateve të kontratës parashikuar në nenin 11, pika 4, ai penalizohet sipas nenit 25, Paragraf II. Bazuar në Procesverbalin përkatës, punimet kanë filluar 20.03.2009 dhe referuar aktit të kolaudit, punimet kanë përfunduar me datë 15.09.2011.

Në monitorimin e realizuar nga AKBN në vitin 2012, cilësohet se nga pikëpamja gjeologjike baseni i presionit është vendosur mbi formacione flishore rrënjësorë me rezistencë të lartë, e cila rrit qëndrueshmërinë dhe sigurinë e veprës. Nga pikëpamja statike, muret e basenit të presionit janë të qëndrueshme nga presioni i ujit si dhe nuk lejojnë filtrimin e ujit.

Në monitorimin e realizuar nga AKBN në vitin 2014, është konstatuar se në tubacionin e turbinave janë vërejtur këputje të bulonave të ankerimit, për të cilat është lënë detyrë që të merren masa të menjëhershme.

Bazuar në shkresën e AKBN nr. 4215 prot., datë 04.10.2024, drejtuar MIE, rezulton se nga ana e koncesionarit janë realizuar disa punime riparuese vetëm në vitin 2024, punime të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e kanalit të derivacionit në një gjatësi 135 m, është riveshur me beton arme një segment tjetër në gjatësi 166 m, është ndërtuar një urëkanal ngjitur me atë ekzistues me gjatësi 15 ml në formë drejtkëndore. Në pjesët e tjera pas tunelit deri tek baseni i presionit nuk janë realizuar punime. Realizimi i këtyre punimeve riparuese pas një kohe shumë të gjatë nga ndërtimi, në një masë të pa konsiderueshme, si dhe jo në veprat kryesore që paraqesin rrezikshmëri, është në kundërshtim me:

- Kontratën Koncesionare neni 4 “Detyrimet e koncesionarit”, ku përcaktohet: *“...Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë. Të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse”*.

- VKM nr. 147, datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 28, pika 3, ku përcaktohet: *“Shfrytëzuesi i objektit mirëmban objektin sipas kërkesave teknike që dalin nga rregulloret dhe udhëzuesit, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe KKDM-ja, si dhe kryen riparime e përmirësime sipas kushteve specifike gjatë periudhës së shfrytëzimit, periudhë që fillon me vënien për herë të parë në ngarkesë të digës nëpërmjet mbushjes së ujëmbledhësit”*.

- Koncesionari nuk ka respektuar marrëveshjen e koncesionit sa i takon fuqisë së instaluar, veprim në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, neni 3, ku përcaktohet: *“Karakteristikat kryesore janë: Fuqia e HEC-it N=5500 kW”*.

- Koncesionari nuk ka respektuar grafikun e punimeve. Punimet nuk kanë përfunduar në periudhën e deklaruar por më vonë, në mos përmbushje të detyrimeve në marrëveshjen e koncesionit, neni 11 “Programi i punimeve”. Pavarësisht këtij veprimi, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nuk rezulton ndonjë penaltet i aplikuar, në kundërshtim me nenit 25 të marrëveshjes së koncesionit, neni 25, ku përcaktohet: *“Mos respektimi i afateve dhe kushteve të kësaj marrëveshje penalizon palët, sipas detyrimeve të marra prej tyre, me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në rast vonesash në realizimin e projektit, të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 11, kur kanë kaluar më shumë se 60 ditë vonesë, Koncesionari detyrohet t'i paguajë MIE për çdo ditë vonesë penaltetin prej 0.01 % të vlerës së investimit të pa realizuar”*.

- Koncesionari nuk ka realizuar të gjitha punimet e parashikuara dhe nuk është kërkuar realizimi i plotë i tyre, kryesisht për rrugën e shërbimit, megjithëse në situacionin pjesor nr. 39.4, datë 03.10.2012, raportohet për punime të realizuara për rrugën lidhëse Bunec-HEC me vlerë 11,278,760 lekë, nga të cilat shtresa asfaltike me vlerë 2,417,760 lekë. *Veprim në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, aneksi 1.*

- Punimet nuk janë raportuar me korrektësi gjatë fazës së ndërtimit të HEC, në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, neni 19.

- Shoqëria koncesionare ka paraqitur dokumentacion me mangësi, megjithatë ky dokumentacion nuk është verifikuar në mënyrën e duhur.

- Bazuar në Udhëzimin e KM nr. 2 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, gjatë procesit të zbatimit të kontratave të punimeve civile, krijohet dosja teknike e cila ndër të tjera duhet të përmbajë projektin e zbatimit, përditësimet e ndryshimet, të miratuara gjatë zbatimit të punimeve, përshkrimet dhe specifikimet teknike, preventivin e punimeve, sipas llojeve e zërave në sasi të çmimet përkatëse dhe ndryshimet e tij. Studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit dhe përditësimet gjatë zbatimit të punimeve. Dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre, libri i masave etj.

Në mungesë të dokumentacionit të mësipërm, si dhe referuar pasaktësisë së dokumentacionit të paraqitur nga Koncesionari në AKBN, si agjenci monitoruese, duke i'u referuar shembjes së murit të basenit të HEC Sasaj, nuk mund të konkludohet apo të nxirren konkluzione, nëse janë respektuar kushtet teknike të zbatimit, si sa i takon proceseve të ndërtimit, ashtu edhe të materialeve të përdorura në ndërtimin e veprës.

- Si sa i takon dokumentacionit, ashtu dhe të inspektimeve të realizuara në vite për HEC Sasaj, në asnjë rast nuk paraqitet inspektimi apo verifikimi i strukturës së basenit për defekte, amortizim apo dhe dëme fizike, në kundërshtim me ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i ndryshuar, neni 9, pikat b dhe c, ku përcaktohet: ***“Shfrytëzuesi është përgjegjësi kryesor për sigurinë e objektit dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme në digë/dambë. Shfrytëzuesi i objektit:***

- mirëmban objektin sipas kërkesave teknike që dalin nga rregulloret dhe udhëzuesit, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe KKDM-ja;

- mbulon të gjitha shpenzimet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin, përmirësimin dhe gjithë veprimtaritë që lidhen me sigurimin e digës/dambës dhe të të tretëve”. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, në asnjë rast, nuk i është kërkuar koncesionarit dokumentacion mbi kontrollin e sigurisë, veprim jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 10, pika B, ku përcaktohet: ***“Kontrolli i sigurisë së digës/dambës ushtrohet gjatë projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes. Ai synon: të verifikojë zbatimin e ligjshmërisë; të zbulojë të metat e mundshme në digë/dambë...”***.

b. Mbi dëmtimin e strukturës së basenit

Pas dëmtimit të strukturës së basenit të presionit të HEC sasaj, me datë 16.01.2025, përfaqësues të AKBN z. E. S., z. E. M., z. A. H. dhe znj. M. F., kanë kryer një inspektim në terren. Në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim citohet se u verifikua pjesa e dëmtuar e basenit të presionit si dhe kanali i shkarkimit. Në këtë procesverbal nuk trajtohen dëmet e shkaktuara palëve të treta nga dëmtimi i strukturës së basenit të presionit.


Grupi i auditimit, me prezencë të Punonjësit të AKBN z. A. H. me datë 21.01.2025, realizoi një verifikim në objektet përbërëse të HEC Sasaj. Verifikimi u përqendrua në dëmet që ka pësuar struktura e basenit me presion, me kapacitet të parashikuar 12000 m³. Nga verifikimi rezultoi se struktura mbajtëse rrethuese e basenit kishte pësuar dëmtim për pasojë derdhje të ujit të depozituar, duke shkaktuar dëme të bimësisë në rrjedhën e malit si dhe në banesa, biznese dhe infrastrukturë.

Nga verifikimi u konstatua se krahas shembjes së murit të basenit, në pllakën beton arme të bazamentit të basenit kishte një çarje e cila është shkaktuar kohë më parë. Çarje të tilla vijnë si pasojë e dobësimit të bazamentit, nga i cili krijohen ulje jo të njëtrajtshme, duke bërë që betoni të punojë në përkulje me forcë më të madhe nga ajo e projektuar. Kjo trysni jep ndikim edhe

në aftësinë mbajtëse të mureve mbajtëse, duke kaluar masën e projektuar dhe rrjedhimisht dëmtim të tyre. Më poshtë paraqitet foto e çarjes.



- Nga verifikimi u konstatua se tubacioni i shkarkimit të brendshëm kishte pësuar bllokim si pasojë e deluvioneve të prepicituara në basën nga prurjet e ujit, veprim i cili krijon vështirësi në boshatisjen e basenit të presionit në raste rikonstruksioni, pastrimi apo avarie.



- Poshtë rezervuarit rezultojnë gërmime për zgjerimin e një rruge, të cilat për një distancë të caktuar janë bërë të padukshme, si pasojë e erozionit nga shkarkimi i ujërave nga dëmtimi i murit të basenit të presionit, veprim i cili ndikon në aktivizimin planeve të rrëshqitjes.



c. Në lidhje me dëmet mjedisore të shkaktuara nga koncesionari.

Bazuar në lejen mjedisore për ndërtimin e HEC Sasaj, dhënë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1161/3 prot., datë 20.02.2012 (nr. Identifikues 527, Vendim nr. 6 i KSHK), pika 3.2 cilësohet: “Me qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyralitetit të përroit në segmentin ku do të ndërtohet hidrocentrali, shoqëria të lejojë hedhjen në shtratin ekzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit Qekologjike = 15 % të prurjes natyrale të lumit dhe të burimeve. Në stinë të thatë kjo përqindje do të jetë më e lartë, në bazë të prurjeve të lumit (deri në 100 % të prurjes), duke mos lejuar në asnjë mënyrë që në rrjedhën e lumit të mos ketë ujë. Kjo sasi uji duhet të lihet në rrjedhën ekzistuese të lumit gjatë të gjithë kohës së funksionimit/shfrytëzimit të HEC-it.

MIE me shkresë nr. 854 prot., datë 10.11.2022, ka dërguar për verifikim pranë AKBN ankesën e fshatrave Fushë-Vërrri, Kalasë, Vergo, Kopacez, Palavli, Bajkaj, Stiar etj., për tharjen e lumit të Kalasës nga Shoqëria Koncesionare.

AKBN me shkresë nr. 836/2 prot., datë 28.09.2023, drejtuar MIE dhe Shoqërisë Koncesionare “E.-S.” sh.p.k, ka vënë theksin në mos raportimin rregullisht nga ana e koncesionarit, në mos përmbushje të nenit 19, të marrëveshjes koncesionare. Në këtë shkresë ngrihet problematika e shkeljes së marrëveshjes së koncesionit, neni 8, sa i takon ujit ekologjik në mënyrë të përsëritur, duke cituar që përveç problematikave dhe shqetësimeve të sjella nga banorët e zonës, mos lejimi i ujit ekologjik sipas detyrimit që rrjedh nga kontrata koncesionare dhe lejes së përdorimit të rezervës ujore, sjell pasoja të rënda mjedisore për florën dhe faunën.

Nga ana e koncesionarit është vepruar në kundërshtim me:

- Marrëveshjen e Koncesionit, neni 8, ku përcaktohet: *“Koncesionari merr përsipër të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit dhe përdorimit të tyre. Organi Shtetëror i Autorizuar, në rast nevojë, asiston në zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkëveprimit dhe të përdorimit të ujit, në interes të përdoruesve të ujit për ujitje dhe të Koncesionarit”.*

- Lejen mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1161/3 prot., datë 20.02.2012, pika 3.2, ku përcaktohet: *“Me qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyralitetit të përroit në segmentin ku do të ndërtohet hidrocentrali, shoqëria të lejojë rrjedhjen në shtratin ekzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit Qekologjike = 15 % të prurjes natyrale të lumit dhe të burimeve. Në stinë të thatë, kjo përqindje të jetë më e lartë, në bazë të prurjes së lumit (deri në 100 % të prurjes), duke mos lejuar në asnjë mënyrë që në rrjedhën e lumit të mos ketë ujë. Kjo sasi uji duhet të lihet në rrjedhën ekzistuese të lumit gjatë të gjithë kohës së funksionimit/shfrytëzimit të HEC-it”.*

Konkluzion:

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e koncesionarit nuk janë respektuar dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin dhe shfrytëzimin e veprës.
- Nga ana e koncesionarit, për fazën e ndërtimit është paraqitur dokumentacion me mangësi, për të siguruar që janë respektuar kushtet teknike të zbatimit në ndërtim.
- Nuk është marrë asnjë masë në lidhje me kontrollin e sigurisë së basenit të presionit, si vepra që paraqet rrezikshmërinë më të lartë sa i takon dëmeve për palët e treta.
- Nga ana e koncesionarit në mënyrë të përsëritur nuk është paraqitur në AKBN dokumentacioni sipas kërkesave ligjore.
- Nga ana e AKBN në vite, duke përfshirë fazën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit, nuk janë bërë monitorime të vazhdueshme, si sa i takon shqyrtimit të dokumentacionit të cilin koncesionari ka paraqitur në AKBN, ashtu edhe sa i takon elementëve të sigurisë së veprave.
- Nga ana e koncesionarit nuk janë realizuar punime mirëmbajtje apo riparimi për veprat e HEC, për një periudhë të konsideruar, madje ato të realizuara në vitin 2024, nuk i përkasin veprave që paraqesin rrezikshmëri.
- Nga ana e koncesionarit, kryesisht nga viti 2022 e në vazhdim nuk është lënë sasia e ujit në shtratin ekzistues të lumit, duke krijuar problematika për ekosistemin si dhe duke krijuar vështirësi për banorët e zonës për ujitje.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësit e punimeve z. Dh. L. dhe z. A. K.

2.4 Mbi pasojat e shkaktuara nga dëmtimi i digës së ujëmbledhësit të HEC Sasaj dhe masat e marra për rikuperimin e tyre.

Nga auditimi konstatohet që:

Në ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, neni 9 dhe 10, përcaktohet:

- **Neni 9** “Shfrytëzuesi i objektit”, përcaktohet: “Shfrytëzuesi është përgjegjësi kryesor për sigurinë e objektit dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme në digë/dambë”.

Shfrytëzuesi i objektit:

a) shfrytëzon burimin ujor të krijuar nga diga dhe ujëmbledhësi, për qëllimin e përcaktuar në projekt. Për rastin e dambës shfrytëzon mundësinë depozituese të krijuar nga damba për mbajtjen e mbetjeve industriale dhe moslejimin e largimit të tyre në mënyrë të pakontrolluar;

b) mirëmban objektin sipas kërkesave teknike që dalin nga rregulloret dhe udhëzuesit, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe KKDM-ja;

c) mbulon të gjitha shpenzimet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin, përmirësimin dhe gjithë veprimtaritë që lidhen me sigurimin e digës/dambës dhe të të tretëve;

ç) kompenson totalisht humbjet që pësojnë të tretët, kur ato e kanë origjinën nga diga/damba dhe

d) në rastin kur dëmet shkaktohen nga forca madhore, pamundësisht të parashikueshme në projekt, në kompensimin e humbjeve merr pjesë edhe shteti;

dh) informon dikasterin përkatës që mbulon destinacionin e digës/dambës, jo më pak se dy herë në vit, për sjelljen e objektit dhe çdo ngjarje që lidhet me sigurinë e tij”.

- **Neni 10**, pika B “Kontrolli i sigurisë së digës/dambës”, përcaktohet: “Kontrolli i sigurisë së digës/dambës ushtrohet gjatë projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes. Ai synon: të verifikojë zbatimin e ligjshmërisë; të zbulojë të metat e mundshme në digë/dambë;

c) të vlerësojë situatat e vështira që mbartin rreziqe për sigurinë e objektit;

ç) sipas rastit, të rekomandojë masa për riparimin e mangësive të konstatuara, shmangien e situatave të vështira dhe të kërkojë në kohë realizimin e tyre.

C. Organet që ushtrojnë kontroll në diga/damba janë:

a) dikasteri ose organi që mbulon qëllimin e objektit për të cilin është ndërtuar diga/damba;
b) Inspektorati Teknik i Digave/dambave (ITD).

Ç. Dikasteri ose organi që mbulon destinacionin e objektit dhe Inspektorati Teknik, Brenda muajit mars të çdo viti, njoftojnë KKDM-në për rezultatet e kontrollit të kryer nga ana e tyre. Në rastin e situatave të jashtëzakonshme të dhënat jepen menjëherë”.

Bazuar në ngjarjen e ndodhur, ku baseni i presionit është dëmtuar, konstatohet se nga ana e koncesionarit nuk janë marrë masa të vazhdueshme për sigurinë e veprave përbërëse të HEC Sasaj dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla. Gjithashtu, nga ana e AKBN nuk janë realizuar monitorime të mjaftueshme si për dokumentacionin e paraqitur nga koncesionari, ashtu dhe për sa i përket inspektimit në terren. Si pasojë e shembjes së murit të basenit të presionit një sasi e konsiderueshme uji ka vërshuar në zonën e banuar duke shkaktuar dëme të bimësisë, të pronave të familjarëve dhe bizneseve të zonës.

Nga ana e grupit të auditimit, me datë 21.01.2025, u verifikua dëmtimi i basenit të presionit të HEC Sasaj, si dhe dëmet e shkaktuara nga vërshimi i ujit. Nga verifikimi u konstatua se, si pasojë e vërshimit të ujit të basenit të presionit, janë shkaktuar dëme në lidhje me bimësinë poshtë basenit, në ndërtesat e banorëve dhe bizneseve si pasojë e zhvendosjes nga uji të baltës dhe të masivëve shkëmborë. Po ashtu, vërshimi i ujit kishte përmblytur një pjesë të territorit të nënstacionit elektrik të kësaj zone, por që në momentin e verifikimit ishte funksional.

Në lidhje me dëmet e shkaktuara, vlerësimin e tyre, apo masa të marra për rehabilitim, nga ana e AKBN nuk u paraqit informacion, pavarësisht se këto dëme vijnë nga mos marrja e masave nga ana e koncesionarit për sigurinë e veprave të HEC dhe monitorimit jo të mjaftueshëm të AKBN për këtë HEC, pra kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjes së koncesionit, për të cilën AKBN është ngarkuar me ligj për monitorim.

“Në marrëveshjen e koncesionit, neni 15 “Sigurimet”, përcaktohet: “Koncesionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së koncesionit. Koncesionari do t’i japë MIE, me kërkesën e saj, dokumentet për të gjitha llojet e sigurimeve. Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari do të përdoren për të rindërtuar, për të riparuar, për të risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale”.

Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, koncesionari ka siguruar nëpërmjet policës së sigurimit nr. 12/GJSG4/196526, pranë Kompanisë “S.” sipas dy seksioneve:

- Sigurimi i pasurisë nga zjarri, rreziqet shtesë të tij, tërmeti, rrëshqitja e tokës dhe përmblytja.
- Ndërprerje e biznesit si pasojë e zjarrit, rrufesë, eksplozionit, rënies së avionit apo pjesëve të tij, tërmetit, rrëshqitjes së tokës dhe përmblytjes.

Pas ndodhjes së dëmtimit, nga ana e AKBN janë inspektuar veprat përbërëse të HEC Sasaj, por nuk ka asnjë korrespondencë në lidhje me masat që duhet të marrë koncesionari në lidhje me dëmet e shkaktuara, por as me pushtetin vendor dhe strukturat përkatëse, veprim në mospërputhje me VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, pika 3, ku ndër të tjera përcaktohet: “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore mbikëqyr veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe hidroenergjetike”.

Nga ana e pushtetit vendor janë marrë masa për evidentimin e dëmeve nga dëmtimi i basenit të presionit. Kanë pësuar dëme rreth 16 familje, dëme të cilat konsistojnë në pajisje shtëpiake, materiale hotelerie, mure rrethues dhe porta të jashtme, pemëtari si agrume apo ullinj, etj.

Konkluzion:

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e koncesionarit është paraqitur polica e sigurimit për periudhën për të cilën është shkaktuar dëmi.

- Nga ana e AKBN nuk është bërë asnjë analizë, për arritjen në konkluzionin për shkaqet dhe pasojat e dëmtimit të basenit të presionit të HEC Sasaj, si dhe hartimin e ndonjë plani emergjent për HEC-et e tjera në monitorim, në mënyrë që të parandalohen dëmtime të mundshme edhe në HEC-e të tjerë, për të cilat AKBN ka detyrimin ligjor për monitorim.

- Nga ana e AKBN, përveç inspektimeve të realizuara nuk është marrë asnjë masë në lidhje me njoftimin e koncesionarit për shkeljet në zbatimin e marrëveshjes së koncesionit, në lidhje me mirëmbajtjen dhe kontrollin e sigurisë së HEC.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

E. M., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit pranë AKBN (i komanduar).

Për sa është trajtuar në tërësi në Raportit Përfundimtar të Auditimit Drejtori Ekzekutiv i AKBN “Mbi Projektraportin e Auditimit”, ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Me paraqitjen e Projektraportit të Auditimit, ka filluar menjëherë puna për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve.

Sa i takon marrjes së masave për kontrollin e dokumentacionit të koncesionarëve gjetë fazës ndërtimore, marrjen e masave për monitorimin e marrëveshjeve koncesionare, AKBN konfirmon që këto procese të specifikuara edhe në rekomandimet e KLSH, janë pjesë e detyrave dhe punës së përditshme të Drejtorisë së Monitorimit dhe Drejtorisë së Energjisë së Rinovueshme, procese të cilat vijojnë dhe finalizohen në raportete e monitorimit.

Në lidhje me rritjen e numrit të monitorimeve në terren cilësohet se ka kushtëzim mbi fondet që AKBN ka në dispozicion.

Në marrjen e masave në bashkëpunim me Bashkinë Himarë për shpërblimin e dëmeve, cilësohet se AKBN i është drejtuar kësaj bashkie me shkresë nr. 605/2 prot., datë 25.02.2025, si dhe koncesionarit me shkresë nr. 605/3 prot., datë 25.02.2025, por nuk është marrë përgjigje. Theksohet se do të do të vijohet me me monitorimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale për rastin përkatës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Nga ana e AKBN duhet të bëhen monitorime të vazhdueshme duke i kushtuar rëndësi të veçantë HEC-eve që kanë struktura dëmtimi i të cilave shkakton pasoja të rënda si në jetë njerëzish ashtu dhe në prona, apo mjedisin.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Baseni i presionit të HEC “Sasaj” Sarandë, është dëmtuar si pasojë e mos respektimit të dispozitave ligjore për realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e tij

Nga verifikimi i realizuar mbi zbatimin e marrëveshjes koncesionare për HEC “Sasaj” Sarandë janë konstatuar një sërë problematikash sistematike në të gjitha fazat e projektit nga projektimi dhe ndërtimi, deri në fazën e operimit dhe mirëmbajtjes. Në mënyrë të përsëritur, koncesionari nuk ka respektuar kushtet teknike të kontratës, afatet e përcaktuara dhe detyrimet ligjore për raportim dhe dokumentacion, duke përfshirë edhe mosrespektimin e fuqisë së projektuar, mungesën e dokumentacionit teknik të plotë, si dhe neglizhencën në sigurimin e strukturave kryesore, veçanërisht të basenit të presionit, dëmtimi i të cilit solli pasoja të konsiderueshme në mjedis dhe komunitet.

Nga ana tjetër, roli monitorues i AKBN-së ka qenë i pamjaftueshëm, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, fondeve të nevojshme dhe mungesës së akteve rregullatore apo metodologjive të detajuara për mbikëqyrje efektive. Kjo ka sjellë si pasojë mospërbushjen e detyrimeve ligjore dhe nënligjore nga vetë autoriteti përgjegjës, duke lejuar devijime të paidentifikuara në kohë dhe në mungesën e veprimeve parandaluese dhe korigjuese.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Pas dëmtimit të strukturës së basenit të presionit të HEC Sasaj, me datë 16.01.2025, përfaqësues të AKBN kanë kryer një inspektim në terren. Në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim citohet se, u verifikua pjesa e dëmtuar e basenit të presionit si dhe kanali i shkarkimit. Në këtë procesverbal nuk trajtohen dëmet e shkaktuara palëve të treta nga dëmtimi i strukturës së basenit të presionit. Me datë 21.01.2025, grupi i auditimit realizoi një verifikim në objektet përbërëse të HEC Sasaj. Verifikimi u përqendrua në dëmet që ka pësuar struktura e basenit me presion, me kapacitet të parashikuar 12000 m³. Nga verifikimi rezultoi se, struktura mbajtëse rrethuese e basenit të presionit kishte pësuar dëmtim për pasojë derdhje të ujit të depozituar, duke shkaktuar dëme të bimësisë në rrjedhën malit si dhe në banesa, biznese dhe infrastrukturë.

Gjithashtu u konstatua se, krahas shembjes së murit të basenit, në pllakën beton arme të bazamentit të basenit kishte një çarje, e cila është shkaktuar kohë më parë. Çarje të tilla vijnë si pasojë e dobësimit të bazamentit, nga i cili krijohen ulje jo të njëtrajtshme, duke bërë që betoni të punojë në përkulje me forcë më të madhe nga ajo e projektuar. Kjo trysni jep ndikim edhe në aftësinë mbajtëse të mureve mbajtëse, duke kaluar masën e projektuar dhe rrjedhimisht dëmtim të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të kërkojnë nga koncesionarët verifikimin me detaje të strukturave të HEC-eve, si për dëmtime të dukshme, ashtu edhe për vendosjen e aparaturave që paralajmërojnë lëvizje, ulje, zhvendosje apo fenomene të tjera, të cilat çojnë në dëmtim të tyre, në mënyrë që të merren masat paraprake për të parandaluar shembjen e tyre dhe shmangien e rrezikshmërisë që paraqesin këto struktura.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga ana e AKBN-së nuk janë realizuar monitorime të mjaftueshme për HEC Sasaj, por dhe për hec-eve të tjera. Mungesa e monitorimeve ka lidhje me mos respektimin nga ana e koncesionarëve të marrëveshjeve përkatëse për paraqitje dokumentacioni në mënyrë periodike, si dhe me mangësi në inspektimet që realizohen në këto hec-e nga ana e AKBN-së. Nuk janë marrë masat e duhura për plotësimin e stafit me specialistët e nevojshëm si dhe nuk janë siguruar burimet financiare të nevojshme për funksionim eficient të këtij sektori, veprime në kundërshtim me VKM-në nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, me ndryshime dhe VKM nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN të merren masa për monitorime të vazhdueshme të HEC-eve, proces i cili kërkon plotësimin e sektorit përkatës me specialistë të fushës, si dhe burime financiare të mjaftueshme, në mënyrë që monitorimi i marrëveshjeve/kontratave koncesionare të realizohet në mënyrë sa më të plotë, duke parandaluar edhe ngjarje me pasoja të konsiderueshme, për vetë rrezikun që paraqesin vepra të tilla dhe veçanërisht digat, si pjesë përbërëse e këtyre hec-eve.

3. Gjetje nga auditimi: Bazuar në ngjarjen e ndodhur, ku baseni i presionit të HEC Sasaj është dëmtuar, u konstatua se nga ana e koncesionarit nuk janë marrë masa të vazhdueshme për sigurinë e veprave përbërëse të HEC Sasaj dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla. Si pasojë e shembjes së murit të basenit të presionit një sasi e konsiderueshme uji ka vërshuar në zonën e banuar duke shkaktuar dëme të bimësisë, të pronave të familjarëve dhe bizneseve të zonës.

Nga ana e grupit të auditimit, me datë 21.01.2025, u verifikua dëmtimi i basenit të presionit të HEC Sasaj, si dhe dëmet e shkaktuara nga vërshimi i ujit. Nga verifikimi u konstatua se, si pasojë e vërshimit të ujit të basenit të presionit, janë shkaktuar dëme në lidhje me bimësinë poshtë basenit, në ndërtesat e banorëve dhe bizneseve si pasojë e zhvendosjes nga uji të baltës dhe të masivëve shkëmborë. Po ashtu, vërshimi i ujit ka përmbytur një pjesë të territorit të nënstacionit elektrik të zonës, por që në momentin e verifikimit ishte funksional.

Nga ana e AKBN janë inspektuar veprat përbërëse të HEC Sasaj, pas dëmtimit, por nuk ka asnjë korrespondencë në lidhje me masat që duhet të marrë koncesionari, as me organet e pushtetit vendor dhe as me vetë koncesionarin, veprim në kundërshtim me VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 23-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: AKBN në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të marrin masa për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara, si për pronën publike ashtu dhe atë private, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e koncesionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bazuar në lejen mjedisore për ndërtimin e HEC Sasaj, dhënë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1161/3 prot., datë 20.02.2012, pika 3.2 cilësohet: “Me qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyralitetit të përroit në segmentin ku do të ndërtohet hidrocentrali, shoqëria të lejojë hedhjen në shtratin ekzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit Qekologjike = 15 % të prurjes natyrale të lumit dhe të burimeve. Në stinë të thatë kjo përqindje do të jetë më e lartë, në bazë të prurjeve të lumit (deri në 100 % të prurjes), duke mos lejuar në asnjë mënyrë që në rrjedhën e lumit të mos ketë ujë. Kjo sasi uji duhet të lihet në rrjedhën ekzistuese të lumit gjatë të gjithë kohës së funksionimit apo shfrytëzimit të HEC-it.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e koncesionarit nuk është respektuar ky përcaktim në mënyrë të përsëritur dhe në periudhë të thatë, duke vepruar në kundërshtim me Marrëveshjen e Koncesionit, neni 8, lejen mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 1161/3 prot., datë 20.02.2012, pika 3.2 dhe akte të tjera të fushës së mjedisit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN të rritet monitorimi i marrëveshjeve koncesionare në lidhje me hedhjen në shtratet ekzistuese të lumenjve të sasisë së ujit ekologjik, sidomos në periudha të thata, me synim eliminimin e problematikave mjedisore dhe shmangien e dëmeve që u bëhen banorëve të zonave përkatëse.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në raportin e monitorimit për 6-mujorin e parë të vitit 2010, të realizuar nga AKBN, kërkesës për paraqitje dokumentacioni, koncesionari i është përgjigjur vetëm me paraqitjen e disa situacione punimesh, pa nënshkrimin e ndonjë mbikëqyrësi të punimeve. Gjithashtu, koncesionari nuk ka paraqitur policat e sigurimit. Në konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti përcaktohet se koncesionari nuk ka përfunduar punimet brenda 40 muajve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes, ose brenda 18.02.2007, por ato janë në fazë

fillestare. Në këtë raport cilësohet se koncesionari duhet të penalizohet për vonesa sipas përcaktimeve kontraktore, veprim i cili nuk rezultoi i plotësuar. Edhe në raportin e monitorimit për 6 mujorin e dytë të vitit 2010 dhe më tej, nga ana e AKBN-së është rekomanduar aplikimi i penaliteteve për mos respektim të afatit të përfundimit të punimeve sipas përcaktimeve në marrëveshje, por nga ana e OSHA-së nuk është vepruar. Mos penalizimi i koncesionarit për mos respektim të afateve të zbatimit të punimeve është në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, neni 25, pika 2.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 12-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN-së, për marrëveshjet koncesionare në fazë zbatimi të punimeve, të merren masa për propozimin dhe aplikimin e penaliteteve, sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria “E.-S.” sh.p.k për periudhën nga data e fillimit të punimeve për ndërtimin e HEC deri me datë 30.01.2010, rezultoi se janë paraqitur situacione pjesore (kopje) të dubluara. Situacioni pjesor në një kopje paraqitet pa asnjë mbikëqyrës punimesh, në kopjen tjetër me nënshkrim të mbikëqyrësit, situacione të certifikuar nga dy mbikëqyrës të punimeve etj., duke paraqitur parregullsi të theksuara. Pavarësisht se punimet janë deklaruar të përfunduara me datë 30.11.2011, pas kësaj date janë paraqitur situacione për punime të realizuara deri me datë 03.10.2012. Edhe pse këto situacione nuk përfshijnë veprat kryesore të hidrocentralit, por lidhen kryesisht me punime dytësore si rehabilitimi i rrugëve dhe sistemimi i skarpateve etj., paraqesin parregullsi në deklarimin e afatit të përfundimit të punimeve të veprës. Bazuar në relacionin teknik, hartuar në zbatim të Urdhrit të Ministrit të METE nr. 4762 prot., datë 17.05.2012, rezultoi se shoqëria koncesionare ka paraqitur aktin e kolaudit të punimeve të datës 15.09.2011. Ky akt nuk është pjesë e dosjes teknike të vënë në dispozicion të grupit të auditimit. Në përmbajtjen e tij nuk përcaktohen elementë thelbësorë si: kohëzgjatja e procesit të kolaudit, vlera e objektit sipas preventivit, vlera e situacionit përfundimtar, apo afati i ndërtimit. Gjithashtu, mungojnë përshkrime të qarta mbi dokumentacionin mbështetës dhe faktik. AKBN me shkresë nr. 3415/1 prot., datë 31.05.2013, i ka dërguar Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), një relacion teknik, ekonomik dhe juridik, në lidhje me zbatimin e të gjitha detyrimeve të përcaktuara në kontratë për koncesionarin “W.” SHA. Në këtë relacion, ndër të tjera përcaktohet se nga krahasimi i preventivit me situacionin përfundimtar rezultoi se nuk janë realizuar disa nga punimet e parashikuara në marrëveshje, ndër të cilat edhe rruga e shërbimit. Sa i takon mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kap. I, pika 14 dhe kap. II, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN të merren masa për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga koncesionari në fazën ndërtimore, me qëllim sigurimin e respektimit të kuadrit ligjor në fuqi, të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve. Gjithashtu, të marrë masa për forcimin e mekanizmave të monitorimit për ndjekjen dhe vlerësimin e përputhshmërisë së punimeve me afatet e përcaktuara në kontratat koncesionare.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 547, datë 09.08.2006 “Për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, e ndryshuar, AKBN është ngarkuar me detyrën e monitorimit të hidrocentraleve (HEC). Megjithatë, në zbatim të këtij vendimi nuk rezultoi të jetë miratuar ndonjë akt nënligjor, rregullor apo manual teknik që të detajojë qartë procedurat, përgjegjësitë dhe mënyrën e kryerjes së këtij procesi monitorimi. Kjo ka sjellë mungesë zbatimi

të detyrimeve të përcaktuara në vendimin përkatës, e cila lidhet gjithashtu dhe me mungesën e fondeve dhe të stafit të specializuar pranë AKBN-së për të mbuluar monitorimin e HEC-eve që ndodhen në fazën e prodhimit të energjisë.

Në marrëveshjen Koncesionare të miratuar me VKM nr. 501, datë 23.07.2004, në neni 19, përcaktohet se koncesionari çdo 6-muaj duhet të raportojë me shkrim tek Organi Shtetëror i autorizuar (OSHA), realizimin e programit të investimit në vlerë e natyrë dhe më pas lidhur me prodhimin e energjisë. Në këtë rast ka munguar në afat kjo korrespondencë e përcaktuar në VKM 501/2004.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2, faqe 12-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN-së, të merren masa për hartimin e një rregulloreje apo metodike të detajuar për monitorimin e hec-ve, duke i dhënë prioritet veprave që paraqesin rrezikshmëri, por dhe elemeteve të tjerë që përcaktohen si detyrime të koncesionarëve nga marrëveshjet përkatëse, si dhe aktet ligjore e nënligjore.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Bazuar në shkresën e AKBN nr. 4215 prot., datë 04.10.2024, drejtuar MIE, rezultoi se nga ana e koncesionarit janë realizuar disa punime riparuese vetëm në vitin 2024, Këto punime kanë përfshirë mirëmbajtjen e kanalit të derivacionit në një gjatësi prej 135 metrash, riveshjen me beton të arme të një segmenti tjetër prej 166 metrash, si dhe ndërtimin e një ure-kanal pranë kanalit ekzistues me gjatësi 15 metra linearë dhe formë drejtkëndore. Në pjesët e tjera pas tunelit deri tek baseni i presionit nuk janë realizuar punime. Kryerja e këtyre punimeve riparuese pas një periudhe të gjatë nga ndërtimi i veprës, në një masë të kufizuar dhe jo në strukturat kryesore që përbëjnë rrezikshmëri potenciale, është në kundërshtim me Kontratën Koncesionare neni 4 “Detyrimet e koncesionarit”, si dhe VKM-së nr. 147, datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, neni 28, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBN duhet të bëhen monitorime të vazhdueshme në lidhje me masat që duhet të marrin koncesionarët pas vënies në shfrytëzim të veprave. Ky monitorim duhet të përfshijë jo vetëm mirëmbajtjen periodike të infrastrukturës ekzistuese, por edhe investimet e domosdoshme për garantimin dhe rritjen e sigurisë teknike të digave dhe veprave të tjera përbërëse të HEC-eve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet teknike në fuqi.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të ndërtimit të HEC Sasaj nuk është krijuar dosja e plotë teknike, e cila ndër të tjera duhet të përmbajë projektin e zbatimit, përditësimet e ndryshimet, përshkrimet dhe specifikimet teknike, preventivin e punimeve, studimet inxhinierike për ndërtimin e objektit dhe përditësimet gjatë zbatimit të punimeve, dokumentacioni teknik për punimet topografike, për punimet që bëhen të maskuara, për punimet e proceset e ndërmjetme, që merren në dorëzim, për provat pa ngarkesë të sistemeve, për ndreqjet e të metave gjatë periudhës së garancisë së punimeve, certifikatat e cilësisë të materialeve e të produkteve, testimet dhe rezultatet e tyre, libri i masave etj.

Në mungesë të dokumentacionit të mësipërm, si dhe referuar pasaktësisë së dokumentacionit të paraqitur nga Koncesionari në AKBN, si organ monitorues, nuk është e mundur të arrihet në një përfundim të saktë nëse janë respektuar kushtet teknike të zbatimit të punimeve për HEC Sasaj. Kjo përfshin si aspektet që lidhen me proceset ndërtimore, ashtu edhe cilësinë dhe përbërjen e materialeve të përdorura në ndërtim.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe inspektimeve të kryera ndër vite për HEC Sasaj, rezultoi se në asnjë rast nuk është kryer inspektim apo verifikim i posaçëm i strukturës së basenit të presionit për defekte konstruktive, shenja amortizimi apo dëmtime fizike, veprime

në kundërshtim me ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, i ndryshuar, neni 9, pikat b dhe c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN të merren masa dhe t’u kërkohej koncesionarëve paraqitja e dokumentacionit të plotë teknik dhe ligjor, sipas marrëveshjeve koncesionare të nënshkruara, me synim përcaktimin e fushave me risk të lartë për dëmtime dhe rritjen e monitorimit mbi bazën e këtyre përcaktimeve.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe verifikimi në objekt rezulton se fuqia e instaluar për HEC Sasaj është 8600 kW. Referuar përcaktimeve të nenit 3 të kontratës koncesionare, fuqia e projektuar dhe e miratuar për këtë vepër është 5,500 kW. Ky devijim nga përcaktimet e kontratës përbën shkelje të drejtpërdrejtë të marrëveshjes koncesionare dhe shoqërohet me problematika të natyrës teknike, të cilat ndikojnë në funksionimin optimal të veprës.

Mungesa e monitorimit gjatë fazës së zbatimit të punimeve ka krijuar hapësirë për shmangie të tilla, të cilat janë të pa riparueshme apo të pamundura për t’u korrigjuar pas vënies në funksion të veprave. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me marrëveshjen e koncesionit, neni 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Nga ana e AKBN, të merren masa për monitorimin e respektimit të marrëveshjeve koncesionare që në fazat e zbatimit, si sa i takon respektimit të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, ashtu edhe sa i takon elementëve të tjerë si instalimi i fuqisë së projektuar, duke propozuar dhe aplikuar penalitetet e përcaktuara në këto marrëveshje.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kreun IV, neni 11, germa “d” dhe “e”, si dhe në Statut-Rregulloren e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 11, i rekomandojmë **Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore:

“Lirim nga detyra” për z. E. S., në cilësinë e Drejtorin Ekzekutiv të AKBN.

Bazuar në nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Statut-Rregulloren e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, neni 26, i rekomandojmë **Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës sipas trajtimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe marrjen e masës disiplinore:

“Largim nga puna”, për z. E. M., në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Monitorimit pranë AKBN (i komanduar).

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion, janë larguar nga detyra dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë

në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “*Lirim nga detyra*”, përkatësisht:

znj. M. H.,

z. E. Sh.,

z. I.B.,

z. A. H.,

z. A. L.,

z. A. Ç. në cilësinë e përgjegjësve të sektorit të monitorimit të HEC-eve, sipas periudhave përkatëse.

Për z. Dh. L. dhe z. A. K., në cilësinë e mbikëqyrësit e punimeve, mangësitë e konstatuara i përkasin periudhës nga viti 2009 deri në vitin 2012.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT